Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEË BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 49/17, 52/17
Datë/Datum. 05.04.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

PSH. nr. 49-52/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT PUBLIK, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 si dhe nenit 106 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe nenit 28 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në përbërje Tefik Sylejmani – Kryetar,Goran Milenkoviq - Referues dhe Blerim Dina-anëtar,duke vendosur sipas ankesës me nr. të protokollit 49 dhe 52/17, të parashtruar nga operatorët ekonomik"Luzern"me seli në Prishtinë dhe OE "Shqiponja"nga Prishtina, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Shërbime të hotelerisë në Kuvendin e Republikës së Kosovës"me nr. të prokurimit 101/16/201/211, të shpallur nga autoriteti kontraktues–Kuvendi i Kosovës , në seancën e dt. 22.03.2017, mori këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohen**, si pjesërisht të bazuara ankesa e operatorit ekonomik "Luzern", me seli në Prishtinë dhe OE "Shqiponja", nga Prishtina, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Shërbime të hotelerisë në Kuvendin e Republikës së Kosovës"me nr. të prokurimit 101/16/201/211, të shpallur nga autoriteti kontraktues–Kuvendi i Kosovës.

II. **Anulohet**, vendimi i autoritetit kontraktues Kuvendi i Republikës së Kosovës lidhur me njoftimin për anulim për aktivitetin e prokurimit me titull: "Shërbime të hotelerisë në Kuvendin e Republikës së Kosovës"me nr. të prokurimit 101/16/201/211, si i pa bazuar dhe lënda kthehet në **ri-vlerësim.**

III. Autoriteti Kontraktues në aftë prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me ketë prokurim .

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin Shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të LPP-së nr. 04/L-042, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues , që nuk respekton vendimin e Panelit Shqyrtues të paraparë me ketë ligj.

V. Operatorit ekonomik ankues "Luzern" dhe OE"Shqiponja"me seli në Prishtinë konform nenit 118 pika 3, i kthehen tarifat e sigurimit të ankesës.

VI. Urdhërohen, OE ankues që konform nenit 36 pika 5 të Rregullores së Punës të OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

AK- Kuvendi i Kosovës ka publikuar njoftimin për kontratë me titull **"Shërbime të hotelerisë në Kuvendin e Republikës së Kosovës"** me nr.prok.101/16/201/211, procedurë e hapur , kontratë për shërbime, vlera e kontratës madhe.

Kriter për dhënie ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Afati i fundit për ofertim ka qenë 22.11.2016, data e njoftimit për anulim të aktiviteti ka qenë 06.02.2017.

Në këtë aktivitet kanë marr pjesë gjithsej gjashte (6) OE. AK ka bërë anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit, me datë 09.02.2017. Kundër këtij njoftimit ka parashtruar ankesë OE:"Luzern" nga Prishtina dhe OE:"Shqiponja" nga Drenasi.

Pretendimet ankimore të OE ankues"Luzern" janë se është shkel neni 7, 59, 60, 61 të LPP-së, ndërsa pretendimet e OE"Shqiponja"janë se është shkelur neni 1,6,56,59,61 dhe 62 të LPP-ës.

Ankesat aprovohen si pjesërisht të bazuara.

OSHP ka autorizuar ekspertin shqyrtues z.Basha për trajtimin e pretendimeve ankimore, i cili ka dhen mendimin e tij dhe ka rekomanduar që të aprovohet vendimi i AK për anulim të këtij aktiviteti.

AK përmes parashtresës me shkrim është pajtuar me mendimin e ekspertit , ndërsa OE-të ankues po ashtu përmes parashtresës me shkrim nuk janë pajtuar me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues në seancën dëgjimore të mbajtur me dt. 22.03.2017, ku të pranishëm ishin përfaqësuesit e OE ankues,përfaqësuesi i AK dhe eksperti shqyrtues paneli shqyrtues shqyrtoi shkresat e lëndës si:dosjen e tenderit me specifikime teknike,ankesat e OE ankues,raportin e ekspertizës së ekspertit shqyrtues si dhe përgjigjet e palëve lidhur me këtë raport e po ashtu bëri edhe dëgjimin e palëve ku në fillim fjala ju dha përfaqësuesit të OE ankues "Luzern" z.Azemi i cili deklaroi: "Lidhur me ekspertizën e ekspertizën e ekspertit shqyrtues nr.49/17 dhe 52/17 si kompani kundërshtojmë në mënyrë kategorike raportin e AK-së. Dosja me volumin e saj ka përfshirë 52 artikuj, dhe nga gjithë këta artikuj vetëm 8 artikuj nuk kanë çmim të tregut, mirëpo kursesi nuk hynë në çmime manipulative. Dy artikuj që janë konsideruar si çmime jo normalisht të ulëta, fjala është për Omëletë dhe Hamburgerët, me çmim 0.70€ ne nuk pajtohemi. Pasi këta i konsideron AK si jo normalisht të ulëta, pasi gjithë e dimë se në treg një hamburger kushton 0.50€.

Këto çmime janë reale dhe perspektivës konkurruese në cilat çmime ndërhynë lehtësimet që ofrohen nga AK si qiraja, kosto e rrymës, ujit, dhe mbeturinat etj.

Këta faktor shumë të rëndësishëm bëjnë shtytje katapultave ku këta tetë artikuj që mbasi si jo çmime tregut që të mos prishin bilancin pozitiv financiarë të biznesit tonë, pasi janë mbi 90% çmime reale. Saktësisht 92% kemi ofruar çmime reale pasi nuk ka kërkuar shpjegime për to. Edhe një fakt shumë i rëndësishëm shkelje nenit 7, 59, 60, mirëpo një fakt i rëndësishëm, këto i thojmë dhe potencojmë një fakt se kur janë kalkuluar artikujt në gjitha pozicionet, në bazë të peshimit me përqindje, në çmim përfundimtar në peshim kompanitë dallojnë shumë pak njëra me tjetrën. Por ka një dallim shumë të madh radikal në mënyrë drastike ku çmimet llogariten për njësi të artikullit. Dallimi në peshim dhe artikuj veç e veç është i madh. Kjo i bie që ne si OE kemi ofertuar me çmimin 51.10€ ,është fjala pa peshim.

Në bazë të analizave tona dhe qasjes në dokumente në AK, kemi pa se OE i parë dhe OE i dytë kanë ofertuar me 31.70 dhe tjetri me 37.50, që në mënyrë administrative ka kriteret e përmbushura.
Për të ardhur ne si OE me 51.10€ ku për njësi na ka eliminuar AK, për ardhjen te shuma e OE dytë 37.5 ne duhet të zbresim 73.5% të shumës tonë për të arritur çmimin e këtij OE. Qfar është e paqartë në këtë rast dhe ku bazohet komisioni vlerësues për eliminim në çmim jo normalisht të ulët. Ky është fakt i pamohueshëm dhe relevant me gjitha tiparet e një fakti që askush nuk mund ta anashkaloj. Qëndrojmë në tërësi pranë ankesës dhe pretendimeve ankimore dhe i propozojmë panelit që të aprovoj ankesën tonë si të bazuar dhe të anuloj vendimin për anulim dhe lënda të kthehet në Rivlerësim".

Në vazhdim fjala iu dha përfaqësuesit të OE ankues "Shqiponja" z.Nika i cili deklaroj: "Ne qëndrojmë pranë ankesës dhe pretendojmë se AK nuk ka respektua rregullat për tender jo normalisht të ulët. Ne jemi përgjigjur me shkrim kërkesave të AK dhe kemi elaboruar çmimet për gjitha dyshimet që AK ka pas, dhe mendojmë se janë çmime të tregut. Ne i kemi ofruar sot panelit 8 kontrata me referenca me çmime identike si këto që AK i ka shpall jo normalisht të ulëta. I ofroj panelit edhe referencat e kontratës dhe çmimoren e shërbime ku nuk kemi pas asnjë vërejtje me njëjtat çmime, nuk kemi vërejtje as për çmim as për shërbim në realizimin e kontratës me Kuvendin e Kosovës. I propozoj panelit shqyrtues të shikohet oferta jonë ku janë 9 kontrata me referenca në ofertën tonë, të realizuara pa asnjë vërejtje nga AK".

Në vazhdim fjala iu dha përfaqësuesit të AK-Kuvendi i Kosovës z.Halili i cili deklaroj: Ne si AK pajtohemi me raportin e ekspertit shqyrtues edhe pse në fjalinë e parafundit mendoj se është një gabim teknik në ekspertizë ku thuhet se nuk ka respektuar në tërësi. AK ka respektua rnë përpikëri gjitha dispozitat e LPP-së , rregullat dhe UOPP dhe rregullat për tender jo normalisht të ulët. Komisioni vlerësues ka bërë hulumtim të tregut, dhe në treg për momentin nuk ka mënyrë tjetër të krahasimit të çmimeve. Asnjë çmim që është nën çmimin e kostos nuk mund të jetë i pranueshëm pasi nuk mund të ekzekutohet. OE shqiponja përmendi kontrata që ka me AK, mirëpo ajo është kontrata e para 5 viteve, dhe për 5 vite ka ndryshime të mëdha në treg. OE-të kanë dhënë sqarime, mirëpo nuk janë përfshirë gjitha elementet që arrijnë deri te çmimi si taksat , tvsh etj. Ne kemi nevojë për këtë shërbim dhe kemi interes të madh ta zgjidhim, mirëpo nuk mundemi të përfundojmë aktivitetin me shkeljet që ekzistojnë. Ne qëndrojmë pran vlerësimit tonë dhe i propozojmë panelit të vërtetoj vendimin e AK në mënyrë që OE-të të ofertojnë me çmime reale".

Në vazhdim fjala iu dha ekspertit shqyrtues z.Basha i cili deklaroj: "AK më rastin vlerësimit të ofertave ka kërkuar sqarime për disa pozicione, dhe në bazë t përgjigjes së dhënë nga OE-të , AK nuk është bindur sipas paragrafit 4 të nenit 61 të LPP-së, si e drejtë e AK-së për vlerësimin e çmimeve. Në seancë përfaqësuesit e OE-ve përmendën disa nga artikujt, mirëpo sa për sqarim për

panelin nuk arsyetuan të paktën një artikull të cilët dy OE-të kanë dhënë çmim të njëjtë , prej 0.10€ "Qumësht Bambi" dhe "Kafe Kapuqino".

Anëtari i panelit pyeti përfaqësuesin e AK se pasi OE pretendon se kanë kontratë me këtë AK, a ka dallim në çmime në këto njësi që tani vlerësohet jo normalisht të ulëta. Në përgjigje z.Halili deklaroj: Ka dallime në çmime në njësi të caktuara, mirëpo ajo kontratë po ashtu është e para 5 viteve. Po ashtu ka dallime në çmime ku për disa artikuj ka fitim të trefishtë ndërsa në disa pika".

Në fjalë përfundimtare z.Azemi deklaroj: "Njerëzit që kanë përvojë në hoteleri, e dinë se në raste të cekura japin çmime jo profitabile për joshjen e klientëve, dhe është absurde të eliminohemi në rast ku 92% të çmimeve i kemi profitabile. Në fjalë përdundimtare z.Nika deklaroj: Produkti që iu referua eksperti shqyrtues, për Kapuqino, është produkt shumica shkumë ku nuk ka çmim të madh për ofrimin e tij. Oferta ësht ëbërë me peshim 60% pije të nxehta dhe të ftohta, 20% ushqimi, ushqim dh epije me porosi të veçantë 20%. Ne e dimë se ujë shiten deri 300 apo edhe 500 ujë në ditë, kurse kapuqino shiten 2 apo 3 në ditë, ne e dimë ku është fitimi. Ne kemi zyre financiare dhe kalkulojmë fitimet, dhe mbetet që vetëm të shikohen a kemi përmbushur kërkesat e dosjes".

Në fjalë përfundimtare z.Halili deklaroj: "Vlerësimi ynë është objektiv , në përputhje me kërkesat e dosjes dhe në përputhje me çmimet e tregut".

Paneli shqyrtues konfirmoi se nuk qëndron pretendimi ankimor i OE"Lucern" se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 59, 60 dhe 61, të LPP-së sepse komisioni vlerësues pran AK ka trajtuar të gjitha ofertat e OE pjesëmarrës në këtë tender dhe bazuar në çmimet e ofruara ka vendosur të kërkoj sqarim lidhur me çmimet jo normalisht të ultë të këtij OE ankues , i njëjti është përgjigjur për pozicionet aty ku ka pas vërejtje nga ana e AK si psh. hamburger me çmim prej 0.50 euro,kapuqino prej 0.10 euro,bambi(qumësht me çokollata) 0.10 euro etj. Për AK përgjigjja dhe sqarimet e dërguara nga ana e OE "Lucern"nuk kanë qenë bindëse dhe AK në pajtim me nenin 61 të LPP-ës ka refuzuar tenderin e këtij OE ankues.

Lidhur me çmimet se nuk kanë qen çmime të tregut këtë edhe vet OE ankues e konfirmon gjatë seancës dëgjimore ku deklaron se është e vërtet se për tetë pozicione nuk ka pas çmime të tregut.

Po ashtu për panelin shqyrtues nuk qëndrojnë pretendimet e OE ankues "Shqiponja"lidhur me pretendimet se AK ,ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 1,6,56,59 dhe 61 të LPP-ës ,sepse edhe ky OE për disa pozicione ka ofertuar me çmime jo normalisht të ultë ku Ak ka kërkuar sqarim për 33 pozicione si psh.file peshku 0.50 euro, mushkri viqi 200 gr.0.40 euro, shpageti boloneze 0.50 euro, kafe kapuqino 0.10 euro, qumësht me qokollat 0.10 euro etj. Sqarimet e dhëna nga ky OE nuk kanë qenë bindëse për AK dhe në pajtim me nenin 61 të LPP-ës ka refuzuar këtë ofertë.

Paneli shqyrtues bazuar në shkresat e lëndës gjeti se ky aktivitet i prokurimit është përsëritur për disa herë dhe i rekomandon AK që të ri-vlerësoj edhe një herë këtë aktivitet të prokurimit me qellim te vërtetimit, nese ofertuesit e ketije aktiviteti te prokurimit, konkretisht çmimet e përshkruara – ofruara, korespodojne me çmimet e tregut duke bërë krahasimin me çmimet referente të publikuara nga KRPP.

Paneli shqyrtues nuk gjeti se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 7 të LPP-ës sepse nuk ka pas favorizim të ndonjë OE pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si: dosjen e tenderit me specifikime teknike,ankesën e OE,raportin e ekspertizës së ekspertit shqyrtues,përgjigjet nga ana e AK dhe OE ankues lidhur me këtë raport të ekspertizës si dhe dëgjimin e palëve paneli gjeti se AK nuk ka respektuar dispozitat e nenit 61 dhe 62 të LPP-ës. Andaj paneli shqyrtues nga provat e cekuar më lartë ,në pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshill juridike:

Kundër këtij vendim nuk është e

lejuar ankesa. Palë e pakënaqura
kundër këtij vendimi mund të ushtrojnë
kërkesë-padi për kompenzim dëmi në

Gjykatën Themelore Departamenti Administrativ

në afat prej 30 ditësh.

KRYETARI I PANELIT SHQYRTUES
Tefik Sylejmani